Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-544 Datë: 30.07.2025

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 16 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, nenit 5 paragrafi 4, 5 dhe 6 si dhe nenit 6 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 01/196 e punës e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, nenin 108 të Ligjit mbi procedurën administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 2016), Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 25.07.2025 nxjerr këtë:

VENDIM

I. Riakreditohet dhe Rivalidohet, institucioni i aftësimit profesional, (IAP) "Korabi Puratos L.L.C". Adresa: Lllapnasellë, Çagllavicë, p.n., Kosovë, Republika e Kosovës, për periudhën pesë (5) vjeçare, përkatësisht nga data 01.05.2024 deri më 01.05.2029, me kualifikimet: **"Bërës Ëmbëlsirash" dhe "Furrëtar".** Kualifikimet Kombëtare Profesionale, me numër total të kredive nëntë (9). Niveli III sipas KKK-së.

1. **"Bërës Ëmbëlsirash"** Qendra e Aftësimit Profesional "Korabi Puratos" ka mundësi reale dhe të zbatueshme për të realizuar trajnim në këto përmasa: për kualifikimin e plotë: numri maksimal i kandidatëve brenda një viti: 135 numri i grupeve totale brenda një viti: nëntë (9). Numri i kandidatëve për grup: pesëmbëdhjetë (15). Për trajnimet/certifikimet modulare: numri maksimal i kandidatëve brenda një viti: dyqind e dhjetë (210). Numri i grupeve totale brenda një viti: katërmbëdhjetë (14). Numri i kandidatëve për grup: pesëmbëdhjetë (15).
2. **"Furrëtar"** Qendra e Aftësimit Profesional "Korabi Puratos" ka kapacitetin për të trajnuar në profilin e plotë **"Furrëtar"** në këto përmasa: numri i kandidatëve brenda një viti: dyzet e pesë (45). Grupe totale brenda një viti: tre (3). Kandidatët brenda grupit: pesëmbëdhjetë (15). Si dhe, për trajnimet/certifikimet 2 javore modulare: numri i kandidatëve brenda një viti: 300. Grupe totale brenda një viti: 20. Kandidatët brenda grupit: 15

II. Obligohet Institucioni të plotësoj kushtet bazuar në vendimin e Këshillit Drejtues dhe kriteret e përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi.

III. Obligohet Institucioni që brenda afatit prej 90 ditëve të dorëzoj në AKK një plan për përmbushjen e rekomandimeve të dhëna nga ekipi i ekspertëve vlerësues.

IV. Institucioni mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.

V. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Në bazë të kërkesës së IAP, "Korabi Puratos L.L.C", të parashtruar në AKK, për riakreditim dhe rivalidim të institucionit "Korabi Puratos L.L.C", për kualifikimet: **"Bërës Ëmbëlsirash dhe Furrëtar"**, niveli III i KKK, AKK, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi ka caktuar ekipet e ekspertëve të jashtëm me qëllim të vlerësimit të institucionit lidhur me përmbushjen e kritereve për riakreditim dhe rivalidim.

Ekipi i ekspertëve, pas shqyrtimit të dosjes së aplikimit më 30.05.2025 dhe 02.06.2025 për kualifikimet: **"Bërës Ëmbëlsirash dhe Furrëtar"**, niveli III, dhe vizitës së realizuar më 03.06.2025, pas përfundimit të procesit vlerësues, ka përpiluar raportet më 07.07.2025.
Bazuar në analizën e dosjes së aplikimit dhe gjetjet gjatë realizimit të vizitës, si dhe raportet vlerësuese të ekipeve të ekspertëve, çështja është proceduar për vendimmarrje në mbledhjen e Këshillit Drejtues të datës 25.07.2025.
Rekomandimet përfundimtare të ekipeve të ekspertëve mbështeten në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit, si: aplikacionet për validim të kualifikimeve, aplikacionet për akreditim të institucionit, raportin e vetëvlerësimit të dorëzuar nga institucioni, si dhe gjetjet gjatë realizimit të vizitave tek pala aplikuese.

AKK, bazuar në nenin 18 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe nenin 23 të Udhëzimit Administrativ MASHT Nr.35/2014, për kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, është e obliguar të realizojë procesin e monitorimit dhe të raportojë tek Këshilli Drejtues.

Andaj, Këshilli Drejtues i AKK-së, referuar dispozitave ligjore, rekomandimeve të ekipit të ekspertëve të dhëna në raportet vlerësuese përfundimtare për akreditim dhe validim të institucionit aplikues, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014, Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD së AKK, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të vendimit.*

Dr. Besim Mustafa
Kryetar i Këshillit Drejtues
Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve

Vendimi u dërgohet:

- Institucioni "Korabi Puratos L.L.C";
- Arkivit të AKK.